



Republika e Kosovës

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSB)–

01.Nr. zyrtar/ 2022



Komuna e Kaçanikut

Procesverbal

Takimi i I-rë i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2022

Më 22.02.2022

Në takim prezantuan:

Besim Ilazi, Kryetar i Komunës

Halim Shehu, Stacioni i Policisë-Kaçanik

Fatmir Qaka, EVSB

Shemsedin Abazi-KLSP

Elmihane Malsiu-HANDIKOS

Fidaim Fazliu, Bashkësia Islame

Ekrem Livoreka, Komiteti për Komunitete

Fadil Guri, Zyra për Komunitete dhe Kthim

Zahir Doda, Drejtor i DAK

Naim Hysa-Kryqi i Kuq Komunal

Bujar Bajra-Sektori i Emergjencave Civile Komunale

Ylber Tusha-Përfajqsuesi i Bizneseve

Vedat Dema-Zyra për Barazi Gjinore

Gzim Morina-FSK

Fadil Guri: propozoj që diskutimin rreth qështjes së sigurisë dhe pyetje për Komandantin e Policisë ti bëjmë në pikën e fundit të rendit të ditës pasi që të diskutohet për Planin e Punës së KKSBB-së.

-Me këtë propozim u pajtuan të gjithë

4.Diskutim rreth Planit të Punës së KKSBB për vitin 2022

Kryetari: sa për informim edhe për anëtarët e rinjë të këtij forumi , ne si komunë sipas Udhëzimit Administrativ për KKSBB-të , minimum në vit duhet që të i mbajmë 6 takime por që nuk përjashtohet mundësia që të mbahen edhe më shumë e që mvaret nga situata e përgjithshme e sigurisë.Planin e punës ua kemi përcjellë , i cili plan është përpiluar nga një grup i përbërjes së vjetër e ne mundë ta diskutojmë dhe ta kompletojmë për ta përcjellë për miratim në Kuvend Komunal.

-Nga të pranishmit nuk pat ndonjë propozim për ndryshim të planit , kështu që ky plan u miratua nga pjesëmarrësit dhe i cili do të përcillet për miratim në Kuvend Komunal.

5.Të ndryshme

Ekrem Livoreka: kam një kërkesë nga Komandanti i Policisë që të shtojë prezencën e patrullave të policisë te stacioni i autobusëve sidomos gjatë mesditës dhe në mbrëmje ngase vet prezenca e policisë e pamundëson krijimin e situatave jo të mira në kët vend.

Fadil Guri: nga raporti që u dha nga Komandanti i Policisë u tha se dukuria e prerjes ilegale të pyjeve ka rënë dukshëm por që mendoj se jemi në sezonin e dimrit dhe kërkesat për masë drusore ka rënë edhe pse ende ka të atillë që përmes automjeteve të motorizuara ende e zhvillojnë kët veprimtari.Kam një kërkesë nga komandanti që ta frekuentojnë edhe pjesën e pyjve që gjindet te varrezat e qytetit, që juridikisht figuron se është pronë shoqërore por që një pjesë e madhe është edhe pronë private dhe në bazë të asaj që shihet në teren pyjet në kët anë janë dëmtuar shumë.

Fidaim Fazliu: dhuna në familje është bërë shqetësuese për shoqërinë dhe unë dyshoj se kjo dukuri është shumë ma shumë e përhapur nga ajo që raportohet.Mendoj se gjithsecili nga ne duhet të kontribojnë aty ku punojmë e veprojmë për të parandaluar kët dukuri në rritje.Shqetësim është bërë edhe dukuria e bulizmit sidomos nëpër shkolla.Është mirë që policia zhvillon legjerata të ndryshme por që mendoj se zyrtarët policorë nuk janë ekspert për të trajtuar tema që kërkohen për tu trajtuar.Raste të vjedhjeve në kët periudhë ka pasur edhe nëpër xhami por çka më brengosë mua është se është kriju një lloj frige për të lajmëruar rastet , ngase procedurat e lajmërimit të rasteve janë shumë monotone , ndërsa shumë pak po mirren me personat që kanë kryer veprën. E kuptoj se është procedurë por që po më duket e tepërt.

Kryetari: në bazë të raporteve që na vijnë shohim që dukuria e dhunës në familje është në rritje, gjithashtu edhe përdorimi i narkotikëve është prezent dhe ne duhet të jemi syqelë që këto dukuri të trajtohen nga institucionet e rendit dhe të drejtësisë .Pajtohem me Kryetarin e Bashkësisë Islame

se procedurat e marrjes së informacioneve nga personat që japin informacione për ndonjë rast janë të stërgjatura . Mendoj se duhet të thirren në takime të tilla edhe zyrtarët nga gjykata dhe të shtrohen këto shqetësime.

K.iPolicisë: sa për informim stacioni i policisë në Kaçanik mbrenda ditës mundë ti ket një ose dy patrulla të policisë që e vështirson prezencën tonë në çdo pikë ngase ne operojmë në një teren që ka afërsisht 40.000 mijë banorë, duke përfshirë Begarcën , Gllloboqicën e deri në Han të Elezit. Pikërisht në stacionin e autobusëve kemi intervenuar disa herë dhe kemi parandaluar ekceset . U përmendë vjedhja e masës drusore te varrezat e qytetit por që në kuadër të pylltarisë janë rojet e pyllit që operojnë edhe në këtë pjesë dhe në bashkëpunim me ne mundemi me u përkujdesë më shumë edhe pse nuk kemi pasur raste të lajmruara.Sa i përket ligjëratave nëpër shkolla ne kemi njësitin e komunitetit të çertifikuar nga MPB dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit kemi bërë një program të koordinuar ku përfshihen tema për bulizmin dhe narkotikët.Lidhur me deklaratat e personave që japin informacione për ndonjë rast është procedurë dhe ai person vetëm një herë jep deklaratë në polici e pastaj lënda përcillet në Prokurori dhe më pas fillojnë procedurat e Gjykatës duke i përfshirë të gjithë akterët e rastit deri në fund të përfundimit të gjykimit. Bashkëpunimi me qytetarë dhe me institucione është i mirë por jo në atë masë për të parandaluar të keqën.

Fatmir Qaka: kam një pyetje për Komandatin e Policisë kur dihet se këtë vit në nivel naciopnal do të bëhet strategjia mbi luftimin e ekstremizmit dhe radikalizmit që të shpie në terrorizëm , a ka mbrenda stacionit policor në komunën tonë ekspert që mundë të trajtojnë këtë dukuri.

K.i Policisë: komuna jonë nuk është vend i rrezikuar ashtu siç është alarmuar nga mediat dhe portalet e ndryshme.Nuk ka indikacione që kjo dukuri të merr përmasa të atij niveli që komentohet. Lidhur me pyetjen që u parashtrua mundë të ju them se një zyrtarë e kemi të trajnuar për këtë temë por që ekspertët janë vetëm nga niveli qendrorë Detyra jonë është vetëm marrja dhe përcjellja e informacioneve në nivelin qendrorë .

Kryetari: në një kohë organizata të ndryshme kanë vepruar në komunën tonë duke organizuar punëtori,ligjërata e trajnime të ndryshme lidhur me temën e ekstremizmit ,radikalizmit që të shpie në terrorizëm dhe ne si komunë kemi kontribuar në zhvillimin e këtyre aktiviteteve.Unë gjithmonë kam qenë kundër çdo epiteti që na kanë dhënë mediat lidhur me këtë dukuri, por që aktivitete që sensibilizojnë qytetarët për parandalim të dukurive negative ne do ti përkrahim.

Fidaim Fazliu:për këtë çështje unë personalisht dua të falënderoj kryetarin për çasjen e duhur që ka pasur në takime të ndryshme nëpër media duke e paraçitur Kaçanikun si një vend i vlerave e duke kundërshtuar çdo raport që është raportuar se gjoja Kaçaniku është çerdhe e xhihadizmit duke ja humbur imazhin e një qyteti të qëndresës historike.

Elmihane Krasniqi: unë vetëm deshta të ju përshëndes dhe të ju përgëzoj për punën që keni bërë deri tash si KKSB dhe besoj se edhe unë si anëtare e re e këtij forumi do e jap kontributin tim në adresimin e çështjeve që kanë të bëjnë me sigurinë qytetare.

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës së Kaçanikut **z.Besim Ilazi** i cili prezantoi pikat e rendit të ditës:

1. Prezentimi i anëtarëve të KKSB
2. Zgjedhja e një proces mbajtësi
3. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut,
4. Diskutim rreth Planit të Punës së KKSB për vitin 2022
5. Të ndryshme.

1. Prezentimi i anëtarëve të KKSB

Në pikën e parë të rendit të ditës u prezantuan të gjithë anëtarët e këtij këshilli

2.Zgjedhja e një procesmbajtësi

2.Kryetari së pari njoftoi të pranishmit se si koordinator të këtij këshilli ka emruar Drejtorin e Arsimit **z.Zahir Doda** ndërsa për procesmbajtës propozoi **Fatmir Qakën**, me të cilin propozim u pajtuan të gjithë anëtarët.

3.Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut

-Rreth pikës së tretë të rendit të ditës Komandanti i stacionit të policisë në Kaçanik **z.Halim Shehu** tha se situata në përgjithësi gjatë kësaj periudhe ndërmjet dy takimeve ka qenë e qetë dhe stabile me përjashtim të disa rasteve që do i përmendë:

Gjithsejtë kemi pasur 65 raste e si më shqetësuese është dhuna në familje. Më të rënda raste janë në familjen Dogani në Kaçanik dhe në lagjen Gjini në fshatin Vataj të Dubravës, ku personat të cilët kanë edhe probleme shëndetsore paraqesin dhunë ndaj familjarëve. Personi në familjen Dogani është në arrest ndërsa personi i dytë është dërguar në mbajtje e më pas në klinikën psikiatrike në Prishtinë.Raste tjera që duhet vequar janë: lëndime të lehta trupore-4 raste, kanosje-6 raste,dëmtim prone -2 raste, kanosje ndaj personit zyrtarë -1 rast,sulm-3 raste,shkaktim i rrezikut të përgjithshëm -1 rast , tentim grabitje-1 rast, hyrje në sistemin kompjuterik-1 rast , vjedhje-14 raste ku prej tyre 10 janë të rënda, përdorim i armëve-2 raste , organizim i skemave piramidale -3 raste,vjedhje e pyllit-3 raste,ngcmim-1 rast, keqpërdorim i fëmijëve-1 rast dhe personi që ka kryer këtë vepër është në paraburgim dhe vjedhje identiteti kemi një rast.Sa i përket situatës me pandeminë gjithësejtë kemi të regjistruar 2394 raste pozitive, janë dhënë 529 xhoba për mosrespektim të masave anti-COVID. Për kundërvajtje në trafik kemi lëshuar 548 xhoba. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit ,përmes njësisë së komunitetit jemi duke mbajtur nëpër shkolla ligjëratat të ndryshme që lidhen me sigurinë e përgjithshme qytetare.

Ekrem Livoreka: problemi i qenve endacak një dukuri që është brengosëse në komunën tonë, më intereson të dijë se çfarë hapa ka ndërmarrë komuna lidhur me këtë dukuri.

Kryetari: kjo dukuri e qenve endacak është shqetësuese në nivel nacional dhe ende nuk është marrë ndonjë masë që do ta trajtonte si duhet këtë dukuri. Janë duke punuar niveli qendrorë për një strategji të qëndrueshme por që për momentin asgjë konkrete nuk kemi.

Gzim Morina: përshëndes takimin , uroj që ky forum do ti adresoj si duhet shqetësimet e qytetarëve dhe ne si FSK do të jemi bashkëpunues çdo herë që kërkohet nga ana e juaj.

REKOMANDIMET:

1. Të shpeshohen patrollimet e policisë në vendet më të frekuentuara
2. Të punohet më shumë në parandalimin e dhunës në familje
3. Të ofrohen programe trajnuese në parandalimin e dukurive negative
4. Një përkujdesje e shtuar në ruajtjen e pyjeve
5. Të gjindet një alternativë më e mirë e bashkëpunimit të akterëve të sigurisë me qytetarët në ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike për shoqërinë në përgjithsi

Kryesuesi: Kryetari i Komunës

z. Besim Ilazi



Procesmbajtës:

Fatmir Qaka